REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 31.01.2019

PËR
MIRATIMIN E AGJENTIT NË SIGURIME NË EMËR E PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "ANSIG" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e z. Astrit Lika për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime për klasat e Jo-Jetës, në emër e për llogari të shoqërisë së sigurimit "Ansig" sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR	**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**
Pajtim MELANI	**Ervin KOÇI**